



**KONTRATË KALIMI KUOTASH
ME SHITJE**

Sot, me date 19.09.2019 (dymije e nentembdhjete), para meje Noter Edlira TELHARAJ, Noter prane Dhomes se Notereve Tirane, me seli ne Blv. Bajram Curri, nr 11, Tirane, u paraqiten palet e meposhtme:

- **Lorenzo ARRIGHI**, atesia Vanni, lindur me 17.11.1967 në Firenze dhe banues ne Itali, madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i identifikuar nga karten e identitetit italiane me nr. AY6411331.

*(i cili këtu e në vijim do të quhet **Shitësi**)*

- **Ylli SULA**, atesia Rexhep, lindur me 01.08.1966 ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i identifikuar me leternjoftimin me nr. Personal G60801162O.

*(i cili këtu e në vijim do të quhet **Blerësi**)*

te cilet, ne baze te Ligjit Nr.110/2018 dt.20.12.2018 "Per Noterine" nenit 761 e vijues dhe e vijues te Kodit Civil, si dhe ligjit Nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate si vijon:

TË DHËNA PARAPRAKE:

- a) Shoqëria "NEXUSCOM BALLKAN" Sh.p.k, është regjistruar si person juridik prane QKR-se, me NIPT L21808019U, me kapital themeltar me vlerë 1.380.000 (nje milion e treqind e tetedhjte mije) leke dhe ka status aktiv.
- b) 51 % te kuotave te Shoqerise "NEXUSCOM BALLKAN" Sh.p.k zoterohen nga Shitesi.
- c) Me vendimine asamblese se ortakete te shoqerise eshte miratuar shitja e kuotes se ortakut **Lorenzo ARRIGHI** ne favor te bleresit **Ylli SULA**.

**Neni 1
Objekti**

- 1.1 Objekt i kesaj kontrate eshte realizimi i shitjes nga Shitesi te Blerësi, i 51 % (pesedhjte e nje %) te kapitalit te shoqerise, kapital i zoteruar teresisht nga Shitesi, dhe zhveshja e ortakut nga te drejtat dhe detyrimet qe buronin nga qenia ortak ne shoqeri, mbi 51 % te kapitalit, duke kaluar keto te drejta te Blerësi **Ylli Sula**.

Neni 2
Çmimi i shitjes

- 2.1 Palet kanë rënë dakort dhe kanë përcaktuar se çmimi total i shitjes se **51 %** të kapitalit të shoqërisë “NEXUSCOM BALLKAN” Sh.p.k është **703.800 lekë (shtateqind e tre mijë e tetqind leke)** vlere e cila është paguar nga Bleresi **Ylli Sula**.
- 2.2 Palet pranojnë dhe deklarojnë se shuma permendur me sipër është likuiduar për llogari të Shitesit perkatesisht nga Bleresi jashte kesaj zyre noteriale dhe palet nuk kane asnje pretendim ne lidhje me te.

Neni 3
Kalimi i pronësisë

- 3.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate realizohet kalimi i 51% te kapitalit te shoqerise “NEXUSCOM BALLKAN” Sh.p.k., nga pala Shitëse te pala Blerëse dhe Shitësi, zhvishet nga të drejtat dhe detyrimet që buronin nga kjo pronësi.
- 3.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate pala Blerëse, bëhet zotëruese e 51 % te Kapitalit te shoqerise duke marre persiper te gjitha të drejtat dhe detyrimet qe burojne nga qenia pronar mbi 100% të aseteve të shoqërisë “NEXUSCOM BALLKAN” Sh.p.k, nga momenti i nënshkrimit.
- 3.3 Blerësi deklaron se eshte dakort me kalimin e 51% te kapitalit te shoqerise ne favor te tij duke mbartur detyrimet qe burojne nga qenia ortak i vetem ne shoqerine “NEXUSCOM BALLKA.” Sh.p.k nga momenti i nënshkrimit..

Neni 4
Deklarime të palëve

- 4.1 Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se, 51 % te kuotave të kapitalit të shoqërisë, “NEXUSCOM BALLKAN” Sh.p.k, që i transferohen Blerësit, janë të lira nga çdo barrë dhe menjëherë lirisht të transferueshme te Blerësi, dhe mbi to nuk ka asnjë të drejtë juridike apo monetare të të tretëve.
- 4.2 Blerësi deklaron se e njeh gjendjen e shoqërisë si me sipër, e pranon transferimin e 51% te kuotave të kapitalit të shoqërisë “NEXUSCOM BALLKAN” Sh.p.k, në favor të vet duke marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet që do te burojnë nga këto kuota te lindura nga momenti i nënshkrimit te kontrates.

Neni 5
Data efektive e kontratës


- 5.1 Kjo kontratë është efektive, e detyrueshme për palët dhe trashëgimtarët e tyre, që nga data e nënshkrimit të saj.

Neni 6
Zgjidhja e Kontratës

- 6.1 Asnjë nga palët nuk mund të zgjidhë në mënyrë të njëanshme këtë Kontratë.

Neni 7
Hartimi i Kontratës, aktet bashkëlidhur

- 7.1 Kontrata u hartua në 4 (kater) kopje të barazvlefshme, në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë ligjore.
- 7.2 Kjo Kontratë zëvendëson çfarëdolloj marrëveshje, kontrate ose çfarëdolloj dokumenti tjetër dhe është e vetmja Kontrate detyruese për Palët në lidhje me objektin e shitjes.

 2

Neni 8

Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni

- 8.1 Kjo Kontratë është hartuar ne bazë të legjislacionit shqiptar ne fuqi.
- 8.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj Kontrate, nëse vetë palët me ndihmë juridike vazhdojnë të mos t'i kuptojnë e zbatojnë, si dhe në rast se vetë palët nuk gjejnë mirëkuptim, mosmarrëveshjet bëhen objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykatës Kompetente.

Neni 9

Interpretimi i Kontratës në tërësi

- 9.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Kontratë.

Kontrata e shitjes se kuotave, iu lexua palëve me zë të lartë e të qartë nga unë noter. U lexua prej vetë atyre dhe, palët pasi deklarojnë se e gjejnë atë të rregullt e në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, e nënshkruajnë në praninë time. Unë noterja e legalizoj rregullisht, ne përputhje me ligjin.


PALËT

SHITËSI

LORENZO ARRIGHI




BLERËSI



NOTER

Edlira TELHARAJ



SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"NEXUSCOM BALLKAN" SH.P.K.
NIPT L21808019U

VENDIM
I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE ORTAKEVE TE SHOQERISE
"NEXUSCOM BALLKAN" SH.P.K

Sot, me datë 17.09.2019, ne zyren e shoqerise vijuan punimet e mbledhjes se Asamblese se Ortakeve te shoqerise tregtare "NEXUSCOM BALLKAN" SH.P.K, me rend dite si me poshte vijon:

- *Miratimin e shitjes se 51% te kuotave te shoqerise te cilat zoterohen nga ortaku Lorenzo ARRIGHI.*

Ne mbledhje jane te pranishem ortaket:

Z.Lorenzo Arrighi zoterues i 51% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise,
Z.Ylli Sula zoterues i 49% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise,

Ortaket e pranishem ne mbledhje, perfaqesojne 100% (njqind perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise te perbere nga 100 kuota.

Pasi, u shqyrtuan dhe diskutuan nga ortaket e shoqerise ceshtjet ne rendin e dites si me lart, Asambleja e Ortakeve te shoqerise "", unanimisht

VENDOSI:


- Te miratoje transferimin me ane te shitjes ne favor te ortakut bleres perkatesisht:
- **Ortaku Ylli Sula** behet zoterues edhe i 51% te kapitalit te shoqerise duke zoteruar ne total 100% te pjeseve te kapitali te shoqerise
- **Ortaku Lorenzo Arrighi**, zhvishet nga te drejtat dhe detyrimet qe buronin nga qenia ortak ne shoqeri mbi pjesen 51% te kapitalit te shoqerise.

Ky vendim u miratua nga ortaket me unanimitet.

ORTAKET E SHOQERISE
"NEXUSCOM BALLKAN" sh.p.k

Z. Lorenzo Arrighi

LORENZO ARRIGHI



Z. Ylli SULA

